

Lezhë, më 25.01.2021

R A P O R T

Drejtuar: Z. Gjakë Jaku, Prefekt i Qarkut Lezhë

**MBI VEPRIMTARINË E GRUPIT TË PUNËS, PËR VERIFIKIMIN E
PROBLEMATIKAVE TË SHFAQURA NË INFRASTRUKTURË, PËR SHKAK TË
RESHJEVE TË DËNDURA PREJ DATËS 22.01.2021 -25.01.2021**

Qëllimi: Evidentimi i problematikave të shfaqura në infrastrukturë, për shkak të reshjeve të dëndura të shiut dhe prurjeve të shtuara të ujit në shtratin e lumit Mat, prej datës 22.01.2021 – 25.01.2021

Grupi i punës: Ilir Ndoka, Sekretar i Përgjithshëm, pranë institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë;
Ndoc Zogu, Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit dhe Kompetencave Vendore, pranë institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë;
Ndrek Mhillaj, Përgjegjës i Sektorit të Emergjencave Civile, pranë institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë;
Gentjan Liçi, Përgjegjës i Sektorit të Zhvillimit Urban, pranë institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë;


Grupi i punës, i ngritur në zbatim të porosisë së Prefektit të Qarkut, sot më datë 25.01.2021, evidentoi problematikat e shfaqura në infrastrukturë për shkak të prurjeve të shumta në lumin Mat, si dhe për shkak të reshjeve të dëndura të ditëve të fundit dhe përgatiti këtë raport përmbledhës.

Nga monitorimi i infrasktrukturës përgjatë shtratit të lumit mat janë evidentuar problematika në 8 (tetë) vendndodhje si shkak i reshjeve të shiut gjatë ditëve të fundit, si më poshtë:

Pika 1

Vendndodhja: Ura e autostradës

U evidentua problemi serioz i zhveshjes së këmbëve të urës, i shkaktur prej rënies së bazamentit të shtratit të lumit. Problematika ka qënë e evidente prej disa kohësh dhe është adresuar disa herë nga institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë në institucionet kompetente dhe në organet ligjzbatuese, për marrje masash dhe për goditjen e shfrytëzimit të paligjshëm të materialeve inerte në këtë zonë. Edhe tani, situata duket e përkeqësuar. Më poshtë po japim disa foto ilustruese;



Pika 2

Vendndodhja: Burgu i Shënkollit

Nga vëzhgimet nuk u evidentua ndonjë problematikë që të përbëjë rrezik;



Pika 3

Vendndodhja: Ura e re e Milotit (Ura e Trenit)

Edhe në këtë pikë u evidentua problemi i zhveshjes së këmbëve të urës, i shkaktur prej rënies së bazamentit të shtratit të lumit, si rezultat i shfrytëzimit të paligjshëm të materialeve inerte në këtë zonë;




Pika 4

Vendndodhja: Segmenti mes dy urave, urës me harqe dhe urës së re

U evidentua gërryerja dhe shembja e peneleve deri afër bazamentit të rrugës, në një distancë prej 1 (një) metër në afërsi të saj. Situata paraqitet emergjente, pasi gërryerja rrezikon seriozisht shembjen e bazamentit të rrugës.

Sugjerohet hapja e një kanali qendror në mes të aksit të lumit, për devijimin e prurjeve, në mënyrë që të zbutet forca goditëse e ujit në zonën e dëmtuar.



Pika 6

Vendndodhja: Zona e Bërzanës, kilometri II nga ura e Zogut

Ka dëmtime në rrugë për shkak të rrëshqitjeve të dheut, si rezultat i reshjeve të dendura të koheve të fundit.